



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1107 / prot.

Tiranë më 28.9.2020

Lënda: Mendim mbi një projektligj

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 16984 Prot., datë 15.09.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” dhe relacionin përkatës, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i relacionit të projektligjit, konstatohet se krijimi i regjistrit qendror të llogarive bankare vjen edhe si detyrim në kuadër të përafrimit të legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe veprave të tjera penale të lidhura me të, konkretisht me Direktivën 2015/849, “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimet e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, ndryshuar me Direktivën 2018/843.

Konstatojmë se projektligji (konkretisht, nenet 6 dhe 11) përmban disa dispozita referuese në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, çfarë nënkupton angazhimin e nismëtarëve të tij për të përmbushur kërkesat lidhur me garantimin dhe respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar edhe në nenin 35 të Kushtetutës.

Zyra e Komisionerit, duke shprehur vlerësimin e saj maksimal për këtë angazhim, vlerëson se, me qëllim garantimin sa më efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, të adresohen edhe disa kërkesa që burojnë, respektivisht, nga dispozitat e direktivës së sipërpërmendur dhe legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kësisoj, propozojmë që fjalia e dytë e pikës 2 të nenit 6 të projektligjit të ndryshohet si vijon:



*“Sistemi ngrihet, administrohet dhe mirëmbahet, në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë së informacionit, të parashikuara në dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Ky propozim bazohet, gjithashtu, edhe në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 21.05.2020, e cila ngarkon Zyrën e Komisionerit për të mbikëqyrur, ndër të tjera, përpunimin e të dhënave personale të kryer nëpërmjet sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Më tej, Zyra e Komisionerit propozon që afati 10 vjeçar për ruajtjen e të dhënave, i parashikuar në pikën 1 të nenit 11 të projektligjit, të ndryshohet në përputhje me dispozitat e Direktivës 2015/849, *“Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimet e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”*, të ndryshuar me Direktivën 2018/843.

Kësisoj, në nenin 40 të Direktivës parashikohet se afati i ruajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë një periudhë 5 vjeçare. Sipas Direktivës, ky afat mund të zgjatet edhe për 5 vite të tjera, bazuar, rast pas rasti, në rrethanat konkrete që diktojnë nevojën për zgjatjen e tij.

Për këtë arsye, ruajtja e mëtejshme e të dhënave personale duhet të paraprihet nga një raport vlerësimi i nevojave dhe proporcionalitetit të ruajtjes së mëtejshme të këtyre të dhënave, duke e konsideruar këtë përpunim (për një afat shtesë 5 vjeçar), si një justifikim të arsyeshëm për përmbushjen e qëllimit të ligjit (neni 2 i projektligjit).

Në përfundim të afatit të ruajtjes, të dhënat personale duhet të fshihen nga Regjistri.

Sa më sipër, propozojmë që pika 1 e nenit 11 të projektligjit të riformulohet si vijon:

*“1. Informacioni i regjistruar në Regjistër ruhet i plotë për 5 vite nga mbyllja e llogarisë bankare apo kasetës së sigurisë. Të dhënat personale mund të ruhen edhe për 5 vite të tjera, nëse, nga vlerësimi i kryer nga autoritetet përgjegjëse, rezulton se afati shtesë i ruajtjes së të dhënave është i nevojshëm dhe proporcional për përmbushjen e qëllimit të parashikuar në nenin 2 të ligjit. Në përfundim të afatit të ruajtjes së të dhënave personale, këto të dhëna fshihen nga Regjistri.”*

Gjithashtu, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 41 të Direktivës sugjerojmë që pika 2 e nenit 11 të projektligjit të ndryshohet si vijon:

*“Përpunimi i të dhënave personale, si dhe informimi i subjektit të të dhënave personale, nga ana e institucioneve financiare, kryhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**